



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 21 korrik 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

**Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për të Thirrur Dëshmitarë
Ekspertë për të Dëshmuar**

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të
Specializuar**
Aleks Uajting

Mbrojtjes së të Akuzuarit
Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykues) nxjerr këtë vendim mbi kërkesën e Mbrojtjes për të thirrur dëshmitarë ekspertë për të dëshmuar.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 24 shkurt 2023, Trupi Gjykues nxori Vendimin mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave dhe Çështje të Lidhura me To, ku konstatoi se: (i) në kontekstin e zbulimit të së vërtetës, në dallim nga palët, viktimat nuk kanë të drejtë të paraqesin prova vetë, në mënyrë të pavarur, por mund t'i kërkojnë Trupit Gjykues të urdhërojë paraqitjen e provave përkatëse ose të thërrasë dëshmitarë për të dhënë dëshmi; dhe (ii) në kontekstin e zhdëmtimit, viktimat kanë të drejtë të paraqesin vërejtje apo prova të rëndësishme në mbështetje të kërkesave të tyre për zhdëmtim.¹

2. Më 4 maj 2023, Trupi Gjykues udhëzoi Mbrojtësin e Viktimave që të dorëzonte brenda 30 qershorit 2023 listën e dëshmitarëve që propozonte të thërriste – duke përfshirë edhe dëshmitarë ekspertë – në lidhje me zbulimin e së vërtetës dhe/ose zhdëmtimin, në rast se Trupi Gjykues jep vendim fajësie.² Gjithashtu Trupi Gjykues bëri të qartë se, kur ekspertët thirren për qëllime zhdëmtimi, si rregull i përgjithshëm, provat e tyre duhen paraqitur dhe vlerësuar me shkrim.³

3. Më 30 qershor 2023, Mbrojtësi i Viktimave i kërkoi leje Trupit Gjykues që të paraqiste: (i) një aktekspertizë të përgatitur nga Karin Duhne-Prinsen dhe Çejen Lozano Parra, dy eksperte të mjekësisë ligjore nga *instituut voor Mensenrechten en Medisch Onderzoek* (iMMO)(Instituti për të Drejtat e Njeriut dhe Vlerësim Mjekësor)

¹ KSC-BC-2020-04, F00433, [Decision on victims' procedural rights during trial and related matters](#), (Vendim mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave dhe Çështje të Lidhura me To), 24 shkurt 2023, publik, para. 21, 27.

² KSC-BC-2020-04, Transkripti i seancës, 4 maj 2023, publik, f. 1356, rreshti 11 deri në f. 1357, rreshti 13.

³ KSC-BC-2020-04, Transkripti i seancës, 4 maj 2023, publik, f. 1359, rreshtat 3-12, që i referohen KSC-BC-2020-05, F00425, [Decision appointing a financial expert and setting out further procedural steps with regard to reparation proceedings](#), (Vendim për Caktimin e Ekspertit Financiar dhe Përcaktimin e Hapave Proceduralë të Mëtejshëm në lidhje me Procedurën e Zhdëmtimit), 1 qershor 2022, publik, para. 10.

mbi dëmin që pretendohet se i është shkaktuar një prej viktimave pjesëmarrëse në proces (V01/04); dhe (ii) një aktekspertizë të përgatitur nga Stefan Lerc, ekspert në llogaritjen e humbjeve në të ardhura, vetëm për dëmet materiale që pretendohet se kanë pësuar të gjitha viktimat pjesëmarrëse në proces (Parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave).⁴ Mbrojtësi i Viktimave gjithashtu i kërkoi Trupit Gjykses të thërrasë të dy ekspertet e IMMO-së për të dëshmuar, nëse do të jetë e nevojshme, në vartësi të ndonjë njoftimi të bërë sipas rregullës 149(2) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).⁵

4. Më 10 korrik 2023, Mbrojtja e Pjetër Shalës (përkatësisht Mbrojtja dhe i akuzuari) dorëzoi një njoftim sipas rregullës 149(2) të Rregullores, ku parashtron se nuk synon të paraqesë kundërshtime ndaj ekspertizës së ekspertëve të propozuar, por se, megjithatë, nuk i pranon as aktekspertizat e tyre dhe as pjesë të tyre, dhe shpreh synimin që t'i marrë në pyetje (Njoftimi i Mbrojtjes).⁶

5. Më 12 korrik 2023, Mbrojtja shtoi edhe një përgjigje ndaj parashtrimeve të Mbrojtësit të Viktimave, duke përsëritur se nuk e pranon përmbajtjen e aktekspertizave të ekspertëve dhe synon t'i marrë në pyetje dëshmitarët ekspertë.⁷ Mbrojtja nuk pajtohet me faktin që Mbrojtësi i Viktimave nuk synon të thërrasë Stefan Lercin për të dëshmuar dhe parashtron se kjo cenon të drejtën e të akzuarit për t'u

⁴ KSC-BC-2020-04, F00558, Mbrojtësi i Viktimave, *Parashtrime të Mbrojtësit të Viktimave në Zbatim të Urdhrit të 4 Majit 2023 ku Përcaktohen Hapat e Mëtejshëm Proceduralë për Paraqitjen e Provave nga Mbrojtësi i Viktimave*, 30 qershor 2023, konfidenciale, me shtojcat 1-6, konfidenciale, para. 9, 58.

⁵ Parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave, para. 2, 14, 58.

⁶ KSC-BC-2020-04, F00578, Mbrojtja, *Njoftim i Mbrojtjes në lidhje me Provat e Dëshmitarëve Ekspertë të Mbrojtësit të Viktimave në Zbatim të Urdhrit të Trupit Gjykses të 4 Majit 2023*, 10 korrik 2023, konfidencial, para. 3. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 13 korrik 2023, F00578/RED.

⁷ KSC-BC-2020-04, F00585, Mbrojtja, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Parashtrimeve të Mbrojtësit të Viktimave në Zbatim të Urdhrit të 4 Majit 2023 ku Përcaktohen Hapat e Mëtejshëm Proceduralë për Paraqitjen e Provave nga Mbrojtësi i Viktimave me Gjashtë Shtojca Konfidenciale (Përgjigja e Mbrojtjes)*, 12 korrik 2023, konfidenciale, para. 9. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 14 korrik 2023, F00585/RED.

përballur me dëshmitarin që dëshmon kundër tij dhe për të kundërshtuar përfundimet e ekspertit duke e marrë atë në pyetje drejtpërdrejt.⁸

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Trupi Gjykes mbështetet në nenet 22(3) dhe (5), dhe 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullat 149 dhe 168 të Rregullores.

III. DISKUTIM

7. Fillimisht, Trupi Gjykes thekson se: (i) aktekspertiza e përgatitur nga ekspertet e iMMO-së për dëmin që pretendohet se i është shkaktuar viktimës V01/04 ka lidhje edhe me zbulimin e të vërtetës edhe me zhdëmtimin;⁹ dhe (ii) aktekspertiza e përgatitur nga Stefan Lerci për dëmin material që pretendohet se u është shkaktuar viktimave pjesëmarrëse ka lidhje vetëm me zhdëmtimet.¹⁰ Meqë të dy aktekspertizat lidhen, të paktën pjesërisht, me zhdëmtimet, Mbrojtësi i Viktimave mund t'i paraqesë aktekspertizat si prova dhe të thërrisë këdo nga dëshmitarët ekspertë pa pasur nevojën e ndonjë autorizimi tjetër nga Trupi Gjykes.¹¹

8. Sa u përket parashtrimeve të Mbrojtjes, Trupi Gjykes vlerëson se duhet bërë dallimi midis eksperteve të iMMO-së - të cilat japin prova edhe për zbulimin e së

⁸ Përgjigjja e Mbrojtjes, para. 9.

⁹ Shtojca 1 e Parashtrimeve të Mbrojtësit të Viktimave. *Shih edhe* Parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave, para. 11.

¹⁰ Shtojca 4 e Parashtrimeve të Mbrojtësit të Viktimave.

¹¹ *Shih* para. 1 më lart dhe, gjithashtu, KSC-BC-2020-04, F00433, Trupi Gjykes I, [Decision on victims' procedural rights during trial and related matters](#), (Vendim mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave dhe Çështje të Lidhura me To), 24 shkurt 2023, publik, para. 44.

vërtetës edhe për zhdëmtimet – dhe Stefan Lercit – që jep prova vetëm në lidhje me zhdëmtimet.

9. Duke pasur parasysh parashtrimet e Mbrojtjes se ajo nuk e pranon aktekspertizën e iMMO-së ose pjesë të saj dhe se dëshiron t'i marrë në pyetje ekspertet,¹² Trupi Gjykses konstaton se, sikurse përcaktohet në rregullën 149(3) dhe (4) të Rregullores, ai nuk mund ta pranojë aktekspertizën e iMMO-së si provë pa thirrur për të dëshmuar ekspertet autore të aktekspertizës. Rrjedhimisht, Karin Duhne-Prinsen dhe Çejen Lozano Parra do të thirren të dëshmojnë përpara Trupit Gjykses duke filluar nga **e hëna, 21 gusht 2023**. Më pas, nëse dëshiron, Mbrojtja mund t'i parashtojë me shkrim kundërshtimet lidhur me pranueshmërinë e aktekspertizës së tyre brenda **të hënës, 4 shtator 2024**.

10. Për sa i përket Stefan Lercit, Trupi Gjykses rikujton konstatimin e tij të mëparshëm që, si rregull i përgjithshëm, procesi për zhdëmtimet të zhvillohet kryesisht me shkrim.¹³ Kjo bazohet në rregullën 168 të Rregullores – që zbatohet si *lex specialis* kundrejt rregullës 149 të Rregullores – dhe e cila përcakton se Trupi Gjykses “mund të ftojë Mbrojtësin e Viktimave dhe personin e shpallur fajtor që të paraqesin vërejtjet e tyre në lidhje me aktekspertizat” (theksimi i shtuar).¹⁴ Meqenëse Stefan Lerci është thirrur nga Mbrojtësi i Viktimave si dëshmitar ekspert vetëm në lidhje me zhdëmtimet, në parim, dëshmia e tij do të pranohet dhe vlerësohet me shkrim. Rrjedhimisht Stefan Lerci, në këtë fazë nuk do të thirret për të dëshmuar.

11. Në rast se Mbrojtja dëshiron t'i drejtojë atij pyetje ose të paraqesë kundërshtime në lidhje me pranueshmërinë e aktekspertizës së tij, ajo udhëzohet ta bëjë këtë me shkrim brenda **së premtes, 15 shtator 2023**. Trupi Gjykses nuk është bindur nga

¹² Njoftimi i Mbrojtjes, para. 3; Përgjigjja e Mbrojtjes, para. 8.

¹³ *Shih poshtëshënimin 3 më lart.*

¹⁴ *Shih edhe KSC-BC-2020-05, F00425, [Decision appointing a financial expert and setting out further procedural steps with regard to reparation proceedings](#), (Vendim për Caktimin e Ekspertit Financiar dhe Përcaktimin e Hapave Proceduralë të Mëtejshëm në lidhje me Procedurën e Zhdëmtimit), 1 qershor 2022, publik, para. 10.*

parashtrimet e Mbrojtjes sipas të cilave mosthirrja e Stefan Lercit për të dëshmuar në gjykatë cenon të drejtën e të akuzuarit për të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij ose për të kundërshtuar aktekspertizën e ekspertit. Mbrojtja do të ketë mundësinë t'i bëjë të gjitha pyetjet që ka dhe t'i paraqesë të gjitha kundërshtimet dhe/ose vërejtjet me shkrim. Pyetjet e veta Mbrojtja duhet t'ia paraqesë Trupit Gjykses me anë të një parashtrimit të protokolluar. Mbrojtësi i Viktimave është përgjegjës për t'ia përcjellë pyetjet Stefan Lercit dhe për t'i paraqitur përgjigjet e Stefan Lercit me anë të një parashtrimit të protokolluar. Mbrojtja mund të parashtrojë vërejtje të tjera shtesë brenda dy javëve pasi t'i ketë marrë këto përgjigje dhe pas kësaj Trupi Gjykses mund ta rivlerësojë më vonë nevojën për ta thirrur ekspertin për të dëshmuar në gjykatë.

IV. VENDIM

12. Për arsyet e përmendura më lart, Trupi Gjykses:

- a. **VENDOS** të dëgjojë dëshmitë e eksperteve të iMMO-së Karin Duhne-Prinsen dhe Çejen Lozano Parra, duke filluar nga **e hëna, 21 gusht 2023**;
- b. **VENDOS** që, në parim, provat e Stefan Lercit të paraqiten dhe të vlerësohen me shkrim, në përputhje me paragrafin 11; dhe
- c. **URDHËRON** Mbrojtësin e Viktimave të dorëzojë një version publik të redaktuar të parashtrimit të protokolluar F00558 (vetëm parashtrimin kryesor, pa shtojcat), ose të kërkojë riklasifikim brenda **të enjtes, 17 gusht 2023**.

/nëshkrimi/

**Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse**

/nëshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nëshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E premte, 21 korrik 2023

Në Hagë, Holandë.